



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Shtator, 2021
Përmes	Muhamet Pervetica, u.d., udhëheqës i Sektorit të shëndetësisë - DSH
Raportuesi	Dr. Fatlinda Hoxha – zyrtare për shëndetësi – DSH

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit shtator 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 69 lëndë, të cilat ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore, përderisa 9 prej tyre ishin kërkesa të përsëritura. Gjithashtu u pranuan edhe 4 kërkesa të kategorive të ndryshme.

Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për tu njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë

- Realizohet faza e gjashtë por edhe faza shtesë e aktivitetit – dezinfektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës;
- Renovimi i objekteve të KPSH – pas takimit me menaxheren e kontratës e cila pasi analizoi situatën vendos të vazhdoj me tutje me aktivitetin e lartpërmendur;
- Furnizim me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore – KPSH, kryesisht furnizimi, montimi dhe përmirësimi i inventarit u realizua nga urdhër blerjet të dërguara më parë. Ky aktivitet u realizua përgjatë kësaj periudhe në objektet QMF 5, QMF 4 dhe AMF në Bardhosh. Ekipi menaxhues pranon kërkesë për furnizim me 100 varëse infuzionesh, por refuzohet pasi duhet ndjekur rrugë tjetër rreth identifikimit të nevojave në terren;
- Hulumtim në vazhdimësi rreth përpilimit të dokumentit - draft Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga dhuna ne familje;
- Miratohet kërkesa - kërkesë furnizim me lëndë djegëse për ngrohje (pelet dhe dru për QMF-të dhe AMF-të) për te vazhduar bashkëpunimin me Drejtorinë e Arsimit

Aktivitetet në prokurim:

- Ri tenderohet – furnizim me autoambulanca për të cilën ofertat planifikohen të hapen më 07.09.2021;
  - Deratizimi i podrumeve dhe garazheve publike si dhe rrjetit të kanalizimit – operatorët ofertues pranuan sqarimet profesionale të kërkuara;
  - Dërgohet për fillim te procedurës se prokurimit – furnizim me teste – D – dimër;
  - Caktohet komisioni për rivlerësim të aktivitetit - furnizim me material shpenzues mjekësor.
- Gjatë periudhës raportuese, situata me pandeminë ishte: 2382 raste totale, 51 vdekje dhe 374 raste aktive.

### 4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Përgatitja e specifikave bazuar në planin e prokurimit 2021;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;

- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore;
- Përgatitje teknike dhe administrative mbi fillimin e muajit për ekzaminime radiologjike – mamografi.

## 5. STATISTIKAT

Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar me buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

**5.1.1.** Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

**5.1.2. Takimet me palë**

- Çdo ditë nga ora 9:00 deri në orën 15:00, DSH bën pranimin e palëve.

**5.1.3. Takimet me institucione tjera**

- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;

**5.1.4. Diskutime publike/takimet me qytetarë**

**5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

**5.1.6. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër**

- 60 lëndë të cilat i përkasin trajtimeve mjekësore, përderisa 9 prej tyre ishin kërkesa të përsëritura dhe 4 tjera ishin kërkesa të kategorive të ndryshme.

**5.1.7. Përfitues të subvencioneve:**

**5.1.8. Takime të tjera**

## 6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## 7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

## 8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente – Prishtinë, gjatë muajit shtator 2021, ofroj shërbime shëndetësore urgjente për qytetarë e Prishtinës dhe fshatrave të Komunës me ekipe mjekësore dhe autoambulanca.

### Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës së urgjencës, ku dominuan rastet me:

- Hipertension arterial,
- Sëmundjet pulmonare obstructive kronike,
- Astma bronchiale,
- Pneumonitë atipike, susp post Covid 19,
- Sindromi akut koronar,
- Ataquet ischemike tranzitore,
- Kokëdhimbjet akute,
- Colicat abdominale,
- Colicat renale,
- Ataquet cerebrovasculare,
- Intoksikimet alimentare,
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut,
- Lëndimet aksidentale etj.

## **Situata me pandeminë COVID-19**

Duke përcjell situatën epidemiologjike gjatë muajit shtator, por edhe nga informatat që kemi nga IKSHP-ja, është një përmirësim dhe zvogëlim të rasteve me COVID-19, të formës delta.

Ekipet nga QMU me sukses menaxhuan rastet duke ju ofruar ndihmë në shtëpi dhe transport me ekip mjekësor dhe autoambulancë deri në klinikat e QKUK-së, ku trajtohen rastet me COVID-19.

Gjatë muajit shtator, nga kolektivi nuk kishte asnjë punonjës të infektuar me COVID-19. Gjatë muajit shtator, në 7 ditë të javës prej orës 07:00 deri në orën 20:00, një ekip mjekësor nga QMU-ja, vazhdoi kujdestaritë në sallën 1 tetori për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat të cilët kishin nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore gjatë vaksinimit.

### **Mbështetja e manifestimeve sportive**

- Më 04 shtator 2021 ekipi mjekësor nga QMU, asiston në stërvitjet e kombëtares së Kosovës dhe Greqisë në Stadiumin "Fadil Vokrri";
- Ndërsa më 05 shtator 2021, dy ekipe mjekësore të QMU-së, asistuan në ndeshjen zyrtare mes reprezentacionit futbollistik të Kosovës dhe Greqisë, e vlefshme për kualifikim në kampionatin botëror të futbollit;
- Ndeshja është luajtur në Stadiumin Fadil Vokrri;
- Më 06 shtator dhe 08 shtator 2021, një ekip mjekësor asistoj me një auto ambulancë në ndeshjet që u zhvilluan në qendrën stërvitore në Hajvali;
- Më 08 shtator, ekipi mjekësor i QMU-së, asiston në stërvitjet e kombëtares së Kosovës dhe Spanjës në Stadiumin Fadil Vokrri;
- Ndërsa më 09 shtator 2021, dy ekipe mjekësore të QMU-së, asistuan në ndeshjen zyrtare mes reprezentacionit futbollistik të Kosovës dhe Spanjës, e vlefshme për kualifikim në kampionatin botëror të futbollit. Ndeshja është luajtur në Stadiumin "Fadil Vokrri";
- Më 14 dhe 15 shtator 2021, QMU me një ekip mjekësor me autoambulancë asistuan në dy ndeshje në kampin e Hajvalisë;
- Me 20 shtator 2021, një ekip mjekësore nga QMU siguruan stërvitjet e reprezentacionit të femrave të Kosovës dhe Norvegjisë;
- Ndërsa me 21 shtator 2021, dy ekipe mjekësore siguruan ndeshjen zyrtare mes reprezentacionit të femrave ndërmjet kombëtarëve të reprezentacionit të Kosovës dhe Norvegjisë, në kuadër të UEFA-së. Stërvitjet dhe ndeshja u zhvilluan në Stadiumin e qytetit „Fadil Vokrri“;

Të gjithë pjesëmarrjet e QMU-së, në këto aktivitete kulturo-sportive ishin të miratuara nga DSH.

## RAPORTI I PËRMBLEDHUR PËR SHTATOR I KORDINATORËS SË SISH -it QMU

1	Vizita e mjekësisë urgjente në terren	1218
	Viz. e mjek. të tjera	4
2	Vizita mjekësore në QMU	0
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. në terren	0
	Shërbimi i rea. ne QMU	0
5	Observim (INTENZIV)	0
6	Shërbimi i infermierisë	0
7	Aksidentet	93
8	Fatkeqësitë në punë	7
	Fatkeqësitë të tjera	52
9	Shërbimi laboratorik	5
10	EKG	7
11	Transportet	289
12	Konstatim vdekjeje	50
	GJITHSEJI	1725

### ZYRA E PROKURIMIT NË QMU RAPORT PUNE PËR MUAJIN SHTATOR 2021

#### ❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese.
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA/2016 të LPP me AQP për kyçe në kontratat e centralizuara.
- Sipas LPB bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranimit të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxherëve të kontratave etj., sipas nevojave të paraqitura.

❖ **AKTIVITETET E ZBATUARA**

- Nxjerrja e urdhër blerjeve në sistemin e FREE BALANCIT për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU,
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me ujë për pije dhe përgatitja për pagesë,
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për shërbime të fotokopjes dhe printerëve me qira dhe përgatitja për pagesë,
- Pranimi i faturës për furnizim me material harxhues administrativ, përgatitja e saj për pagesë.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës .

**ZYRA E FINANCAVE NË QMU  
RAPORT PUNE PËR MUAJIN SHTATOR 2021**

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës në lidhje me shpenzimet dhe të hyrat gjatë tremujorit të tretë (TM-III).

❖ **AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA**

- Përgatitja e lëndëve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre,
- Shpenzimet e telefonit për muajin gusht,
- Shpenzimet e tel. në “Xhemajl Ibish” për muajin gusht,
- Mbushje telefonike për punëtor për muajin gusht,
- Furnizim me ujë për pije për muajin gusht,
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin gusht,
- Furnizim me karburante për muajin gusht,
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj., për muajin gusht,
- Përgatitja e pagave për 3 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin gusht,
- Përgatitja e formularëve me dokumente përcjellëse për punëtorët e rinj.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPËR**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë,
- Fatura e rrymës,
- Sigurimi i autoambulancave,
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve,
- Mbushje telefonike për punëtorë,

- Përgatitja e ndërrimeve të natës,
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera,
- Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imtë.

Faturat e lartcekura janë të rregullta çdo muaj dhe duhet të përgatiten me të gjitha dokumentet përcjellës dhe të dërgohen në DSH.

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

### RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
  - Tre qendra të mjekësisë familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në orën 07:00),
  - Të gjitha qendrat e mjekësisë familjare punojnë me orar të rregullt (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00),
  - Në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare është riorganizuar kujdestaria e rregullt mujore e shtune (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diele (07:00 deri në orën 19:00) d.m.th. kalon sikur në ditë të rregullt pune e organizuar në punë ekipore (d.m.th. të gjitha qendrat të cilat nuk kanë punuar të dielën prej orës 13:00 tani kanë punuar deri në fund të shtatorit me këtë orar. Nga muaji tetor vikendet kthehen në normalitet.
  - Në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës janë punuar 5.550 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit ku janë punuar 1.495 D-dimera, që të dyja këto falas, po ashtu janë punuar edhe testet serologjike 160 pacient të testuar me teste serologjike;
  - Numri i konsultave virtuale gjatë muajit shtator ka arritur në 130 konsulta;
  - AMF në Bardhosh pas renovimit filloi punën me 03.09.2021;
- Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik, orari i punës (07:00 deri në orën 15:00), shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 7/24;
- Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 dhe 13:30 deri në orën 20:00);
- QMG orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);



- Shërbimi specialistik orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- Mjekësia e punës orari i punës (07:00 deri në orën 15:00);
- DAT orari i punës (07:00 deri në orën 13:00);
- Laboratori qendror orari i punës (07:00 deri në orën 14:00 -13:00 deri në orën 20:00);
- Radiologjia, orari i punës (07:00 deri në orën 13:00), në funksion për momentin janë dy njësi radiologjike në QKMF dhe në QMF 5;
- Shërbimi i vaksinimit, orari i punës (08:00 deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye se pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësorë nga dt. 29.03.2021, janë duke kontribuar në sallën "1 Tetori", rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID-19.

Kemi 7 ekipe të përbëra nga mjekë dhe infermier gjithsejtë 26 punëtorë nga QKMF dhe ekipet mbështetëse nga MSH :

-Numri i stafit të infektuar gjatë muajit shtator është 7 punëtor shëndetësor të infektuar.

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës), nuk janë konstatuar mangësi serioze.

- Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Vizita mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
80426	71189	79986	11407	2889	245897

### **Poliklinika Stomatologjike QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

Numri i pacienteve në shërbimin stomatologjik te QKMF Prishtinë: 4611,

Numri me participim 534,

Të hyra 1323.50 euro,

Shërbimi i rëntgenit ne poliklinikën stomatologjike QKMF,

Numri i grafive 470 - numri me participim 151,

Të hyra 226.50 euro,

7 punëtorë në pushim mjekësor, 1 punëtor pushim të lindjes , 2 punëtorë më, 4 punëtor COV +.

Dy vizita në QMF 5 dhe takim me punëtorët e poliklinikës stomatologjike në shumicën e ordinancave,

Një takim me drejtorin e QKMF-së, dhe përfaqësues nga Komuna për shkak të plasaritjes në objektin e Poliklinikës Stomatologjike.

Një kërkesë për furnizim me material shpenzues stomatologjik nga kontrata kornizë.